



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 216 prot.

Tiranë, më 15.02 2024

URDHËR I BRENDSHËM  
Nr. 36, datë 15.02.2024

PËR CAKTIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR  
DISKRIMINIM TË CILAT DEPOZITOHEN NGA PUNËMARRËSIT

Në mbështetje të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”,

**URDHËROJ:**

- I. Caktimin e procedurës për shqyrtimin e ankesave për diskriminim të cilat depozitohen nga punonjësit si më poshtë vijon:

Punëmarrësit që pretendojnë se janë diskriminuar mund të paraqesin një ankesë së bashku me provat e disponueshme dhe t'i depozitojnë pranë Zyrës së Protokollit me shkrim ose me anë të postës elektronike zyrtare të TKOBAP. Ankesa duhet të përmbajë: emrin e ankuesit, subjektin që pretendohet të ketë kryer diskriminimin ose shpjegim për pamundësinë e identifikimit të tij, shpjegimin e diskriminimit të pretenduar, masat që kërkohen të merren nga ana e institucionit, datën dhe firmën e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm ngrihet një komision i cili shqyrton çështjen duke marrë informacion nga ankuesi, nga subjekti ndaj të cilit ankuesi është ankuar si dhe nga çdo person ose burim tjetër dhe kur e sheh të përshtatshme, komisioni zhvillon një seancë dëgjimore me palët.

Drejtori i Përgjithshëm, pas propozimit nga komisioni, shprehet me vendim i cili u njoftohet palëve brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankesës ose nëse është zhvilluar një seancë dëgjimore, brenda 30 ditëve nga dita e seancës. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës si dhe të marrë shpjegime për vendimin e marrë nga punëdhënësi në përgjigje të ankesës së tij menjëherë pas shqyrtimit.

- II. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për komunikimin e këtij urdhri.
- III. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Abigeila Voshtina